



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

---

Numri i lëndës: 2022:050447  
Datë: 17.05.2024  
Numri i dokumentit: 05701217

**K.DH.Sh.II.nr.92/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “T.C Ziraat Bankasi A.S” Dega në Kosovë me seli në rrugën Ukshin Hoti nr. 13 në Prishtinë kundër debitorëve “Bektashi” ShPK me seli në rrugën .... nr. ... në Prizren, A.Ç. me vendbanim në rrugën .... nr. ... në Prizren, E.Ç. me vendbanim në rrugën .... nr. ... në Prizren, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1548/22 të datës 31.10.2023, me datë 16.05.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorëve A.Ç. dhe E.Ç. nga Prizreni, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1548/22 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1548/22 të datës 31.10.2023, në dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve A.Ç. dhe E.Ç. nga Prizreni, i ushtruar kundër urdhrorit përmbartimor P.nr.82/2022 të datës 03.03.2022 të përmbartuesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët, (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1548/22 të datës 31.10.2023, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “T.C Ziraat Bankasi A.S” Dega në Kosovës, ka lëshuar Urdhrin përmbarimor P.nr.82/2022 të datës 03.03.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin me të cilin ka kërkuar që nga debitorët “Bektashi” Sh.p.k me seli në rrugën në Prizren, A.Ç. me vendbanim në Prizren, E.Ç. me vendbanim në Prizren (këtu e tutje Debitorët) ta realizoj kërkesën në shumën prej 32,910.34€ me kamatëvonesë dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Propozimit për përmbarim ia kishte bashkëngjitur në kopje të vërtetuar te noterja Arta Morina Mustafa me seli në Prizren kontratën për kredi me numër K0219/57 të datës 06.09.2019; shtojcën 1: marrëveshja për pengun të datës 06.09.2019; shtojcën dy: plani i pagesave; dy lista të pengut të luajtshëm nr. K0219/57 të datës 06.09.2019; konfirmimin e regjistrimit të pengut R-20190906-333 si dhe dokumentet e identifikimit të Debitorëve dhe sendeve të lëna peng.

Përmbaruesi më 03.03.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbarimor P.nr.82/202 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri). Debitorët më 14.03.2022 kanë parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ata kanë deklaruar se i kanë lidhur marrëveshjet e cekura më lartë, mirëpo arsyet pse i kanë ndalur pagesat kanë pasur të bëjnë me situatën pandemike. Kanë shprehur gatishmëri që ta bëjnë pagesën sipas marrëveshjes, nëse Kreditori e tërheq Propozimin. Prapësimi nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk kanë kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi.

Kreditore ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin. Ai ka deklaruar se Debitorët përmes Prapësimi e kanë pohuar borxhin dhe se Prapësimi nuk është i mbështetur në dispozitat e LPP-së. Ka shtuar se gjendja pandemike nuk është arsye për mos përmbushje, sepse debitori nuk ka pasur asnjë

kufizim, meqë operon në sektorin tregtisë me artikuj ushqimor dhe jo ushqimor. Sipas tij, pas pranimit të Prapësimit i kanë ftuar debitorët që ta bëjnë pagesën, por ky fundit ka deklaruar se për momentin nuk kanë mundësi, ndërsa në të ardhmen nëse e shesin ndonjë paluajtshmëri, atëherë e bëjnë pagesën. Përgjigjes në prapësim nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1548/22 të datës 31.10.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve A.Ç., dhe E.Ç. nga Prizreni, i ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.82/2022 të datës 03.03.2022 të përmbaruesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar të gjitha këto kushtet të kërkuara me nenin 22 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7a të LPP për caktimin e përmbarimit në bazë të kontratës për pengun, pasi kontrata është e lidhur me shkrim dhe sendet e lëna peng janë regjistruar në Regjistrin e Pengut në ARBK, dhe se kontrata e kredisë, shtojcë lidhur me pengun si dhe konfirmim për rregjistrimin e pengut janë të noterizuar nga noterja Arta Morina, po ashtu ka shtuar se nuk ishte kontestues fakti i mos përmbushjes së detyrimit nga debitori.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarimin sipas dokumentit të përmbarimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Ligjit për Procedurën Përmbarimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore ku në mesin e dokumenteve përmbartimore në bazë të cilave organi përmbartues mund të caktoj përmbartimin është edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti përmbartimor, Marrëveshja mbi pengun e datës 24.04.2019, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata mbi kredinë nr. 200719633 e datës 24.04.2019, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrim R-20190426-286, si dhe Marrëveshja mbi pengun e datës 25.08.2020, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata mbi linjën e kredisë nr. 200726180 e datës 25.08.2020, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20200828-310, paraqesin dokumente përmbartuese në kuptim të dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, me të cilën parashihet se *“1. Dokumente përmbartuese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”* ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut. Andaj, Marrëveshja për Pengun është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pengut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe si e tillë paraqet titull përmbartimor në pajtim me dispozitat e lartcekura.

Dhoma e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjta mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 te LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi ti refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.92/24, me datë 16.05.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri